

KoHA: Komiteti i kësaj qendre është duke e kryer zyra pritëse dhe ajo e arkivit, por jo ashtu siç kërkohet me udhëzim, ngase do të duhej të hapej një qendër e re me punëtorë profesionistë. Administrata e Klinikës përbëhet nga shumë punëtorë, të cilët

transparent, si dhe njoftjes së qytetarëve me informacionet e nevojshme, lidhur me procedurat, kushtet, ligjet, afatet kohore të paraqitjes së kërkesave. Qendra duhet të vendoset në hyrje të mjediseve të ndërtesave komunale si kon-

Bashota, thotë, se me anë të këtyre udhëzimeve organet e nivelit qendror na obligojnë të formojmë komisione e zyra, por mjete nuk na japin dhe kjo paraqet problem në zbatimin e tyre.

© KOHA Ditore

obligim të sigurojë procesin e kthimit”, ka thënë ai.

Organizata IOM ka bërë kërkesë në adresë të Komunës më datën 30 maj 2013 për përcaktimin e këtyre parcelave, ndërsa Komuna i është përgjigjur pozitivisht.

nuk mund t'ia japin personit të tretë në shfrytëzim, apo të kenë pretendime uzurpimi”, ka thënë mes tjerash kryetari i Shtërpcës, Bratislav Nikoliq.

© KOHA Ditore

YAHR: Legjislativi komunal i frikësuar nga monitorimi i punës



Nga gjetjet e monitorimit dhe nga praktikat që janë zhvilluar për periudhën gjashtëmujore organizata joqeveritare YAHR thuhet se ka reaguar ndaj shkeljeve ligjore që janë bërë nga Komuna e Lipjanit, sidomos me rastin e mosdaljes për shqyrtim publik të propozimrregullores për taksa dhe tarifa komunale, pastaj propozimrregullores për caktimin e qirasë për dhënie në shfrytëzim të tokës bujqësore, banesave dhe lokaleve afariste që janë në pronësi komunale

Arian Duriqi

LIPJAN, 3 QERSHOR – Asociacioni Rinor për të Drejtat e Njeriut (YAHR) ka publikuar raportin e shtatë monitorues mbi punën e legjislativi komunal në Lipjan, ndërkohë që theks të veçantë ka vënë mbi pengesat dhe telashet që po shkaktohen gjatë monitorimit. Madje drejtuesi i kësaj OJQ-je ka shkruar se legjislativi në gjetjet e kësaj organizate vepron me bojkot dhe frikë.

“Organizata joqeveritare YAHR ka reaguar ashpër ndaj administratës komunale të legjislativi të Komunës së Lipjanit për mosdërgimin e materialeve (të seancës së 35 të Kuvendit Komunal të Komunës së Lipjanit) organizatës sonë. Ky ishte një bojkot apo frikë e Administratës Komunale të legjislativi të Kuvendit Komunal ndaj organizatës sonë, pasi që në këtë seancë janë diskutuar për disa vendime të rëndësishme të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt tek interesi dhe mirëqenia e qytetareve të Komunës së Lipjanit. Kështu që ndoshta kanë dashur që të jenë të mbyllur ndaj shoqërisë civile”, ka thënë Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në YAHR, ndërsa ka shtuar se ky veprim i legjislativi ishte në

kundërshtim me ligjin për qasje në dokumentet publike nr. 03/L-215 të datës 07.10.2010 të Republikës së Kosovës, neni 1; 4; 6; në bazë të nenit 5, dhe me rregulloren komunale për transparencë. Raporti, sipas tij, gjithashtu përmban analiza kualitative të legjislativi në fuqi dhe praktikave më të mira mbi vetëqeverisjen lokale të cilat përdoren në lidhje me gjetjet dhe përgjegjësitë e Komunës. Mirëpo nga gjetjet e monitorimit dhe nga praktikat që janë zhvilluar për periudhën gjashtëmujore organizata joqeveritare YAHR thuhet se ka reaguar ndaj shkeljeve ligjore që janë bërë nga Komuna e Lipjanit, sidomos me rastin e mosdaljes për shqyrtim publik të propozimrregullores për taksa dhe tarifa komunale, pastaj propozimrregullores për caktimin e qirasë për dhënie në shfrytëzim të tokës bujqësore, banesave dhe lokaleve afariste që janë në pronësi komunale.

“Pra Komuna e Lipjanit nuk ka organizuar asnjë debat publik me qytetarët e saj, ku këto rregullore kanë të bëjnë me interesin publik. Propozim – rregulloret u kanë shkruar drejtpërdrejt kuvendarëve për miratim për seancën e 35-të, e cila është mbajtur më 30 janar 2013. Andaj kemi kërkuar nga ku-

vendarët që mos ta miratojnë këto projektregullore dhe që t'i kthehen prapë propozuesit për respektimin e proceseve ligjore (që është bërë një gjë e tillë nga kuvendarët). Pra me këto akte kemi të bëjmë me shkeljet ligjore: Ligji për vetëqeverisjen lokale 2008 nr.03-L040 Kreu IX I”, ka thënë Krasniqi. E gjatë periudhës janar-maj 2013, pjesëmarrja në diskutime e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Lipjanit në lidhje me pikat e rendit të ditës, sipas raportit, është karakterizuar me një rritje krahasuar me vitet e tjera. Anëtarët e LDK-së në Kuvendin e Komunës së Lipjanit në këtë periudhë kanë shënuar një nivel në rritje të pjesëmarrjes në diskutime në katër seancat e mbajtura deri më tani nga periudha janar-maj 2013. Ata, siç shkruan raporti, kanë shënuar ngritje të lehtë nga 29.82 në 32 për qind. Kurse anëtarët e PDK-së kanë pasur një nivel konstant pothuajse krahasuar me periudhën janar-qershor 2012. Në diskutime kanë lëvizur nga 19.3 në 19.17 për qind. Derisa në pjesën e parë të vitit 2013 kanë qenë aktivë vetëm 21 këshilltarë ose 70 për qind prej tyre.

© KOHA Ditore